

DEKLARATË

Dështimi i Komisionit të Reformës Zgjedhore, këmbanë alarmi për zgjedhjet e ardhshme dhe proceset e tjera reformuese të nevojshme për vendin

Dita e djeshme shënoi përmbyshjen e 6 muajve nga nisja e veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore¹. Ky Komision u ngrit nga Kuvendi i Shqipërisë më datë 10 shkurt 2022, plotësimi i anëtarësisë së tij u bë 4 muaj më vonë më datë 9 qershor 2022 dhe seanca e parë për konstituimin e tij që u zhvillua më datë 17 qershor 2022 ishte njëkohësisht seanca e fundit, duke shënuar *de-fakto* përfundimin e tij² pa nisur ende punë.

Pavarësisht deklarimeve dhe angazhimeve të marra gjatë së vetmes mbledhje të zhvilluar, prej atëherë e deri më sot nuk pati asnjë reagim nga asnjë prej anëtarëve të Komisionit apo partive politike të përfaqësuara aty, duke vazhduar lënien në heshtje dhe shënuar politikisht dështimin e tij.

Ky dështim i punës së këtij Komisioni, nuk është i pari në historikun e funksionimit të Komisioneve të Posaçme të ngritura pas miratimit të Kushtetutës, por në raport me kontekstin e gjendur dhe nevojat imediate që paraqiten, angazhimet politike të ndërmarra, sjelljen politike të treguar dhe ecurinë e tërë procesit, **përbën një moment absurd, totalisht joserioz dhe mjaft shqetësues për Institucionin më të lartë të vendit, Kuvendin e Shqipërisë.**

Shteti shqiptar, në Samitin e Stambollit të vitit 1999, është angazhuar për të “zbatuar në mënyrë të menjëhershme vlerësimet dhe rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet”³.

Mospërmbyshja e këtij detyrimi së bashku me moszhvillimin e përgjegjësive të ngarkuara nga Kushtetuta dhe ligji përballë qytetarëve dhe vendit, si dhe mosmbajtja e angazhimeve

¹ [Vendimi Nr. 12/2022 datë 10.02.2022](#) i Kuvendit të Shqipërisë “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për realizimin e reformës zgjedhore”.

² Deri më sot nuk është adresuar asnjë nga detyrimet e përcaktuara nga Kuvendi në vendimin e ngritjes së tij, si dhe asnjë nga angazhimet e deklaruara nga bashkë-Kryetarët e Komisionit gjatë së vetmes mbledhje të tij. Për më shumë shih [regjistrimin video të kësaj mbledhje](#), pasi proces-verbali i seancës ende nuk është zbardhur dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit të Shqipërisë.

[Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë](#), e përditësuar, në nenin 121/1 “Llogaritja e afateve”, pika 4 përcakton se nuk llogariten periudhat jashtë sesionit parlamentar, me përjashtim të rastit kur çështja përfshihet në rendin e ditës të sesionit të jashtëzakonshëm. Duke qenë se sesioni i dytë parlamentar përfundoi më datën 29 korrik 2022, 10 ditëshi i mbetur sipas afatit 6 mujor kalendarik, shtyhet në sesionin e tretë parlamentar që fillon më datë 5 shtator 2022. Ndërkohë, sipas [Vendimit nr. 16, datë 4.7.2022 të Konferencës së Kryetarëve](#) “Për miratimin e çështjeve të diskutuara në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve të zhvilluar më datë 4.7.2022”, përpos miratimit të programit të punës së Kuvendit deri më datë 29.07.2022, u mor edhe vendimi për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrative-Territoriale, Komision ky i ngritur me të njëjtën nismë politike, po me afat 6 mujor kohëzgjatje dhe në të njëjtën ditë me Komisionin e Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore. Për zgjatjen e afatit të këtij të fundit nuk pati asnjë nismë zyrtarisht, madje as edhe si artikulum publik nga asnjë prej deputetëve apo partive politike.

³ “25. Ne ri-konfirmojmë detyrimin tonë për të zhvilluar zgjedhje të lira dhe të ndershme në përputhje me angazhimet e OSBE-së, në veçanti me Dokumentin e Kopenhagenit 1990. ...

Ne pranojmë të ndjekim menjëherë vlerësimet dhe rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet. ...”. [Dokumenti i Stambollit, “Karta për sigurinë evropiane: III. Reagimi ynë i përbashkët”, 19 nëntor 1999, paragrafi 25.](#)

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

politike e institucionale ndaj organizmave dhe aktorëve ndërkombëtarë e vendas, ngarkon me përgjegjësi tërë klasën politike në vend, **në mënyrë të drejtëpërdrejtë faktorin politik parlamentar dhe, në veçanti, mazhorancën socialiste, e cila po lejon denatyrimin në mënyrë të paprecedent të funksionit normal të Parlamentit të vendit**⁴.

Merita kryesore e Zgjedhjeve Parlamentare 2021, megjithë problematikat serioze që shënoi, qëndron pikërisht në faktin e kthimit në shtratin institucional të komunikimit dhe dialogut politik, pas krizës së tejzgjatur politike 2017 – 2020, e cila kulmoi në vitin 2019 me daljen e opozitës nga parlamenti, braktisjen prej saj të zgjedhjeve vendore të atij viti e tërë ngërçet e tjera institucionale e politike që i paraprinë apo pasuan.

Përpara Legjislaturës aktuale të Kuvendit të Shqipërisë shtrohen dhe pritet të zhvillohen përgjegjësi madhore politike e kushtetuese, duke kthyer në normalitet funksionimin e shtetit dhe sistemit tonë demokratik, duke e funksionalizuar siç duhet atë, si dhe duke nxitur, dhënë jetë e institucionalizuar dialogun e nevojshëm politik për të adresuar sfidat e mëdha me të cilat përballet vendi dhe ndërmarrë reforma kuptimplote e të duhura.

Një qasje e tillë duket se mungon, përse kohë **deputetët shqiptarë ngurrojnë të të pranojnë fuqinë dhe luajnë rolin e tyre të dhënë nga Kushtetuta e Republikës**, se ata përfaqësojnë në Parlament vullnetin e deleguar të sovranit dhe janë aty për të mbrojtur dhe zhvilluar më tej vetëm interesat e qytetarëve dhe të së ardhmes së vendit. **Sjellja verbërisht dhe reagimi sipas dhe në funksion të interesave të ngushta të partive politike** që i kanë kandiduar, apo të lidërshipeve të tyre, nuk është as kushtetuese, as ligjore, as demokratike dhe as morale.

Tërë krizat politike të prodhura nga klasa politike, por edhe krizat dhe ngërçet institucionale të prodhura sërish prej saj, apo edhe dështimi i qëllimshëm i zhvillimit të “një procesi të mirëfilltë” në reformat që nevojiten të ndërmerren, rëndojnë mbi **qytetarin shqiptar** dhe të ardhmen e tij.

Po ashtu, tërë proceset zgjedhore, nëpërmjet të cilave legjitimohet pushteti qeverisës i politikës, e sidomos ato tre të fundit, **kanë dëmtuar dhe vazhdojnë të rëndojnë vetëm mbi qytetarët, të drejtat dhe liritë e tyre kushtetuese**, pavarësisht propagandës, angazhimeve dhe premtimeve të bëra në emër të tyre dhe në interes të tyre.

Nëpërmjet një Qëndrimi Publik, të publikuar më datë 11 qershor 2022, Koalicioni për Reformë, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) ngriti shqetësimin pikërisht për mungesën e këtij **angazhimi serioz dhe të vërtetë në adresimin e problematikave madhore për të siguruar integritetin e votës dhe të procesit zgjedhor**. Madje në këtë Dokument⁵, KRIIK renditi edhe disa shqetësime e rekomandime imediate që, sipas tij, nevojiten të ndërmerren për të mundësuar minimizimin e problematikave të vërejtura më

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

⁴ “10. Thëkson nevojën që Kuvendi i Shqipërisë të shtojë përfshirjen në procesin e integritetit evropian duke përmirësuar zbatimin e kompetencave të veta legislative, të mbikëqyrjes dhe buxhetimit; e nxit Kuvendin të përparojë më tej në reformat elektorale dhe territoriale dhe mirëpret krijimin e komisioneve përkatëse parlamentare. ...” . [Rezoluta e Parlamentit Evropian e 19 majit 2022 mbi Raportin për vitin 2021 të Komisionit Evropian për Shqipërinë. \(2021/2244\(INI\)\)](#), paragrafi 10.

⁵ KRIIK, [Qëndrim Publik “Deputetët dhe Kuvendi i Shqipërisë duhet të përmbushin përgjegjësitë e tyre për nisjen e punës dhe realizimin e një Reforme të vërtetë Zgjedhore, të mbështetur në parimet e transparencës dhe gjithëpërfshirjes”](#), publikuar më datë 11.06.2022.

parë, si dhe përmirësimin e standardeve në zgjedhjet e ardhshme vendore të pranverës 2023.

Dështimi i qëllimshëm i Komisionit duket se është në vazhden e **zhbërjes së aspiratave të Marrëveshjes Politike të 5 Qershorit 2020**, të shmangies nga diskutimi publik e institucional të problematikave madhore që shqetësojnë lirinë e votës dhe integritetin e zgjedhjeve, si dhe të **ruajtjes së status quo-së në demokracinë shqiptare**, rrjedhimisht edhe të të njëjtave standarde dhe pritshmëri që do t’iu ofrohen qytetarëve shqiptarë në zgjedhjet e ardhshme vendore.

Mos adresimi i një sërë çështjesh lidhur me problematikat e vërejtura nga zbatimi dhe praktika ligjore e ndjekur në zgjedhjet parlamentare të shkuara dhe ato të pjesshme të 6 marsit 2022, mbi drejtimin e votës, financimin e fushatës zgjedhore, keqpërdorimin e burimeve shtetërore, fushatën në media përfshirë median sociale, fushatën nga palë të treta, etj, në gjykimin e KRIIK, në procesin e ardhshëm zgjedhor **duket se do t’i sigurojë sërish avantazh elektoral mazhorancës qeverisëse socialiste.**

Mos ndjekja e parimeve të premtuara e angazhimeve të shprehura për futjen e votimit parapëlqyes për kandidatët e këshillave vendorë, ecuria e deritanishme e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale, si edhe mos deklarimi qartazi për aplikimin ose jo në zgjedhjet vendore të 2023-it të ndarjes së re administrative, nëse do të ketë një të tillë të dakordësuar nga Komisioni, **përbën një qasje shqetësuese të mazhorancës dhe opozitës parlamentare në vazhdimin e konsiderimit të Pushtetit Vendor veç si një shtojcë apo zgjatim elektoral të pushtetit qendror.**

KRIIK risjell në vëmendje të mazhorancës qeverisëse dhe Partisë Socialiste opinionin e përbashkët të Komisionit të Venecias dhe ODIHR se “demokracia e udhëhequr nga sundimi i ligjit nuk ka të bëjë vetëm me respektimin formal të procedurave që i mundësojnë shumicës të udhëheqë, por edhe me **diskutimet dhe shkëmbimin kuptimplotë të pikëpamjeve ndërmjet shumicës dhe opozitës**. Komisioni i Venecias dhe ODIHR i nxisin forcat politike shqiptare – si brenda, ashtu edhe jashtë parlamentit – që të sigurojnë funksionimin normal demokratik të institucioneve në vend në interes të popullit shqiptar⁶”.

Në këto momente shumë të rëndësishme për të ardhmen e vendit dhe të demokracisë, në raport me sfidat rajonale e ndërkombëtare, është e domosdoshme që **politika shqiptare të tregojë vizion e maturi të lartë, duke dalë sa më parë nga politika konfliktuale e interesave minore, personale dhe nga propaganda e ditës**, duke i dhënë hapësirën e duhur e nxitur funksionimin normal ligjor e demokratik të mekanizmave, institucioneve dhe të gjithë aktorëve dhe faktorëve në shoqëri në funksion të një demokracie të gjallë e funksionale.

Partitë politike nevojitet të reflektojnë thellë mbi rolin e tyre kushtetues dhe madhor në shoqëri, për të prodhuar një politikë koherente, vizionare në funksion të interesave më të mira të qytetarëve dhe të së ardhmes demokratike të vendit.

⁶ Pika 34 e Opinioneve Nr. 1006/2020, CDL-AD(2020)036. Opinion i përbashkët “Mbi ndryshimet në kushtetutë më 30 korrik 2020 dhe në Kodin Zgjedhor më 5 tetor 2020”, datë 11.12.2020, Komisioni Europian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) dhe Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSCE/ODIHR).

Vetëm zhvillimi i një politike të tillë bazuar në parime, standarde e ligje demokratike do të mundësojë përballjen me sfidat madhore të vendit në ndërtimin e shtetit ligjor e të së drejtës, të luftës pa kompromis kundër korrupsionit galopant dhe krimin të organizuar.

KRIIK i bën thirrje partive politike parlamentare, në veçanti lidershipit politik të mazhorancës dhe Kreut të Qeverisë, të ushtrojnë dhe zhvillojnë përgjegjësitë e tyre politike e institucionale për të funksionalizuar demokracinë në vend, ndërmarrë dhe bërë përpjekje të vazhdueshme për të zhvilluar e siguruar një dialog politik domethënës, dakordësuar politikisht qasje vizionare dhe konkretizuar më pas ato në procese reformuese të hapura në parlament, ku të sigurohet pjesëmarrja domethënëse dhe gjithëpërfshirëse e qytetarëve dhe aktorëve të tjerë me ekspertizë.

Tiranë, më 11.08.2022!

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania